



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr 9280 prot.

Shkodër, me 22.04.2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacionin dhe projekt-vendimin

**“PËR PËRCAKTIM TË ÇMIMIT MAKSIMAL TË ÇADRAVE DHE SHEZLONGËVE
PËR ZONËN BREGDETARE VELIPOJË – RRJOLL PËR ZBATIM NGA SUBJEKTET
PRIVATE”**

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr _____ prot.

Shkodër, me _____.____.2026

PROJEKT-VENDIMI

Nr. _____, datë _____.____.2026

**“PËR PËRCAKTIM TË ÇMIMIT MAKSIMAL TË ÇADRAVE DHE SHEZLONGËVE
PËR ZONËN BREGDETARE VELIPOJË – RRJOLL PËR ZBATIM NGA SUBJEKTET
PRIVATE”**

Këshilli i Bashkisë Shkodër, sot me datë ____/____/2026, në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr. 93/2015 “Për turizimin”, të ndryshuar; nenit 6/1 të Vkm nr.649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar; pas shqyrtimit të relacionit nr.____.prot, datë _____ të administratës së bashkisë Shkodër, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Shkodër;

V E N D O S I:

1. Miratimin e çmimit maksimal për qiradhënie të 1 (një) çadre dhe 2 (dy) shezlongëve në vlerën **900 lekë me t.v.sh.**, për plazhin e Velipojës dhe Rrjollit.
2. Miratimin e çmimit maksimal për qiradhënie të 1 gazebo në vlerën **1,500 lekë me t.v.sh.**
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



Zv. Kryetar

Alban Reka

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik

Belin Reno

Drejtoria e Juridike

[Signature]

Drejtoria e Turizmit

Renato Dumqi

Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit

Mihel Kopçej

Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

G. Durrës

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të territorit

DIONIS DRAGANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË
TERRITORIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM EKONOMIK

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

DREJTORIA E TURIZMIT

Nr _____ prot.

Shkodër, me ____ . ____ .2026

RELACION

**“PËR PËRCAKTIM TË ÇMIMIT MAKSIMAL TË ÇADRAVE DHE SHEZLONGËVE
PËR ZONËN BREGDETARE VELIPOJË – RRJOLL PËR ZBATIM NGA SUBJEKTET
PRIVATE”**

Drejtuar: Këshillit Bashkiak, Shkodër.

Të nderuar këshilltarë,

Velipoja dhe Rrjollit përbëjnë dy nga zonat bregdetare më të frekuentuara gjatë sezonit veror, të preferuara nga pushuesit si për qëndrime ditore ashtu edhe për pushime afatgjata. Këto destinacione janë tashmë të konsoliduara dhe të njohura gjerësisht, duke u frekuentuar nga një numër i lartë pushuesish, kryesisht nga qyteti i Shkodrës, por edhe nga bashkëkombës nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut. Për zonën bregdetare Velipojë–Rrjoll, Bashkia Shkodër ka hartuar dhe po zbaton një plan zhvillimi, i cili synon rritjen e sipërfaqeve publike, si dhe garantimin e ofrimit të shërbimeve me pagesë, nga vetë Bashkia ashtu edhe nga subjektet private, në përputhje me standardet e kërkuara të cilësisë. Ky plan synon krijimin e mundësive reale për akses të barabartë për çdo vizitor/pushues që dëshiron të shfrytëzojë këto hapësira bregdetare.

Velipoja përfaqëson një pasuri të rëndësishme natyrore të bregdetit shqiptar dhe, si e tillë, kërkon ruajtje dhe zhvillim të qëndrueshëm, në përputhje me parimet e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të turizmit, duke ofruar shërbime të përshtatshme për fluksin e lartë të vizitorëve dhe me çmime konkurruese.

Ndryshimet e fundit ligjore që rregullojnë administrimin dhe menaxhimin e plazheve dhe sipërfaqja e konsiderueshme e plazheve në Velipojë dhe Rrjoll, përmirësojnë kushtet e nevojshme

për frekuentim nga të gjithë pushuesit, përmes rritjes së aksesit publik, duke kontribuar në shtimin e numrit të frekuentuesve gjatë sezonit turistik.

Këto ndryshime, përmes VKM nr. 60, datë 28.01.2026 për disa ndryshime dhe disa shtesa në VKM nr. 649, datë 16.10.2024 “për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, reflektojnë konstatimet nga Ministria e Turizmit dhe AKB me mospërputhjen dhe variacionin e madh sa i përket tarifave të aplikuara nga subjektet private që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në plazhin e Velipojës me çmime të çadrave që variojnë nga **500 – 2000 lekë për çadër** sipas zonës apo rrjeshtave të çadrave dhe muajve të pikut, dhe **1000 – 2000 – 3000 lekë për gazebot**.

Mungesa e një kufiri maksimal tarifor ka sjellë rritje të pabazuara dhe të paunifikuar në kosto të cmimeve, mungesë të transparencës në afishimin e cmimeve dhe ankesa të shpeshta nga pushuesit në lidhje me çmimet, duke cënuar kështu interesin publik dhe imazhin turistik të Velipojës.

Pikërisht për të rritur aksesueshmërinë për çdo pushues për të pasur mundësinë e zgjedhjes së një plazhi

1. pa pages,
2. plazhi me pagesë të administruar nga Bashkitë
3. plazhi të menaxhuar nga subjekte private,

me çmime të përballueshme, janë bërë ndryshimet përkatëse përmes VKM nr. 60, datë 28.01.2026 për disa ndryshime dhe disa shtesa në vkm nr. 649, datë 16.10.2024 “për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”.

Përmes nenit 6/1 të vendimit të sipërcituar i jepet e drejta Këshillit Bashkiak, përmes vendimarrjes, përpara fillimit të çdo sezoni turistik, të miratojë çmimet maksimale për secilën zonë bregdetare në territorin e Bashkisë.

Ky çmim tavan do të jetë pjesë integrale e kontratës së lidhur mes AKB-së, Bashkisë si përfituese dhe Subjektit Privat si përdorues.

Përmes këtij relacioni dhe projekt vendimi synohet që të përcaktohet, sipas nenit 6/1 të VKM 60 datë 28.01.2026, çmimi tavan për shërbimin e çadrave dhe shezlongëve në plazhin e Velipojës dhe Rrjollit me qëllim:

- Mbrojtjen e konsumatorit dhe interesit publik
- Garantimin e aksesit të barabartë të qytetarëve dhe pushuesve në shërbimet e nevojshme në plazhe
- Shmangien e abuzimeve me çmime përgjatë sezonit turistik
- Krjimin e një standardi të unifikuar dhe transparent për operatorët privatë

Ky propozim do të mundësojë që Velipoja të vazhdojë të rritet si një destinacion turistik atraktiv, duke ofruar kushte të përshtatshme e me shërbime cilësore për të gjithë vizitorët që zgjedhin këtë

zonë për pushimet e tyre por duke ofruar edhe çmime të përballueshme nga të gjithë. Ndryshimet ligjore në lidhje me administrimin e plazheve private dhe publike të menaxhuara do të sigurojnë që këto hapësira të shfrytëzohen në mënyrë të qëndrueshme duke synuar mbajtjen dhe rritjen e numrit të frekuentuesve në plazhin e Velipojës dhe Rrjollit.

Sa më sipër referuar bazes ligjore: të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr. 93/2015 “Për turizimin”, të ndryshuar; nenit 6/1 të Vkm nr.649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar;

Duke vlerësuar:

- Masivitetin dhe frekuentueshmërinë e lartë të Velipojës dhe Rrjollit;
- Profilin ekonomik të pushuesve që frekuentojnë këto zona;
- Nevojën për garantimin e një niveli të përballueshëm tarifor për familjet dhe vizitorët ditorë;
- Sigurimin e një raporti të drejtë ndërmjet kostos së ofrimit të shërbimit dhe çmimit të aplikuar;
- Nxitjen e konkurrencës së ndershme ndërmjet subjekteve private dhe shmangien e praktikave abuzive.

propozojmë miratimin e këtij projekt vendimi për:

Përcaktim të çmimit maksimal për qeradhënie ditore të 1 (një) çadre dhe 2 (dy) shezlongëve, në vlerën **900 lekë me t.v.sh.** në plazhin Velipojë dhe Rrjoll.


Përcaktim të çmimit maksimal për qiradhënie të 1 gazebo në vlerën **1,500 lekë me t.v.sh.** në plazhin Velipojë dhe Rrjoll.

Tejkalimi i çmimeve maksimale përbën shkelje kontraktore dhe shkak për vendosjen e masave administrative dhe/ose zgjidhjen e kontratës.


Duke ju falenderuar!


KRYETAR
Benet BECI


Zv. Kryetar

Alban Preka 


Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik

Belvir Neme 

Drejtoria e Turizmit

Renato Luoms 

Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit

Mikel Lepsaj 

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të territorit

DIONIS DRAGAN 